



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI " FAN S. NOLI "
KORÇË**

**Adresa: Shëtitore "Rilindja" Tel/Fax: ++355 82 242230; ++355 82 242580
Web: www.unkorce.edu.al e-mail: rektorati@unkorce.edu.al**

MIRATOHET:

REKTORI

Prof. as. dr. GJERGJI MERO

FAKULTETI I I SHKENCAVE TË NATYRËS DHE SHKENCAVE HUMANE

**PROGRAMI I STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BIOLOGJI-KIMI,
ME KOHË TË PLOTË**

VITI AKADEMIK 2015-2016

PËRGJEGJËS I GRUPIT MËSIMOR KËRKIMOR TË BIOLOGJI-KIMISË

Dr. Arben Gjata

DEKANI

Prof. Dr. Gjergji Pendavinji

1. EMËRTIMI I PLOTË I PROGRAMIT TË STUDIMIT:

BIOLOGJI-KIMI

2. FORMAT E STUDIMIT

Forma e studimit është me **kohë të plotë**.

I organizuar nga institucioni

Gjuha e zhvillimit të programit është gjuha shqipe

3. VENDIMET E ORGANEVE PËRGJEGJËSE PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT:

Vendimi i Keshillit të Ministrave Nr.352, datë 12.05.2010

Vendimi i Senatit akademik të Universitetit "Fan S. Noli" **Vendimi Nr.11, datë 16.03.2010**

Këshilli i Fakultetit: Vendimi Nr.4, datë 23.09.2013 *Miraton ndryshimet në planin mësimor të degës Biologji-Kimi*

4. PËRSHKRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

1	Kohëzgjatja e programit të studimit në vite akademike	3 vite akademike
2	Semestra	6
3	Kohëzgjatja e programit të studimit në javë mësimore	90 javë mësimore
4	Numuri i krediteve	180
5	Orët mësimore në auditor	2219
6	Ngarkesa minimale javore	24.7 orë javore

5. OBJEKTIVAT FORMUESE

Qëllimi i programit të studimit

Programi i studimit ka për qëllim:

- Të përgatitë mësime të suksesshëm, me aftësi të thella profesionale në fushën e **Biologji–kimisë**, cilësi të larta morale dhe shoqërore për t'u kthyer në modele frymëzuese dhe motivuese për nxënësit.
- Të pajisë studentët me njohuri të përshtatshme teorike dhe shprehje praktike për arritjen e standardeve të larta në mësime në fushat e **Biologjisë dhe Kimisë**, në shkollat ku do të punojnë, duke zbatuar teoritë dhe praktikën e arsimit në lidhje me karakteristikat e grupmoshave, përparësitë e arsimit në vendin tonë dhe rolin e mësuesit si profesionist në një kontekst social në ndryshim.
- Të përgatitë mësime si njerëz të aftë për të punuar dhe për të ndihmuar në komunitet.
- Të përgatitë mësime të motivuar për të punuar në të gjitha zonat e rajonit dhe më gjerë për të ndihmuar në zhvillimin e tyre, rritur cilësinë dhe efikasitetin e shërbimeve.
- Të përgatitë studentë të suksesshëm, për të vazhduar studimet e Ciklit të Dytë “Master Profesional” dhe “Master Shkencor”.

Programi i studimit suksesin e tij e bazon:

- Në kompetencën dhe eksperiencën e stafit akademik, dhe ndihmës, një staf me një përvojë të gjatë në fushat e **Biologjisë dhe Kimisë**.
- Në eksperiencën akademike prej 44 vjetesh në lëndet dhe modulet e **Biologjisë dhe Kimisë** që ka Universitetit “Fan S. Noli” i Korçës.
- Në infrastrukturën moderne në përgjithësi dhe laboratorët bashkëkohorë të **Biologjisë, Kimisë dhe Mikrobiologjisë** që janë ngritur për këtë qëllim pranë Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Humane.
- Në kerkesën e madhe që ka tregu i rajonit të Korçës për këta specialiste.

Objektivat e përgjithshme të programit të studimit:

Objektiva të përgjithshme që ka ky program studimi, janë:

- Pajisja e studentëve me njohuri të përshtatshme teorike dhe shprehje praktike për arritjen e standardeve të larta në mësime në shkollat ku do të punojnë, duke zbatuar teoritë dhe

praktikën e arsimit në lidhje me karakteristikat e grupmoshave, përparësitë e arsimit në vendin tonë dhe rolin e mësuesit si profesionist në një kontekst social në ndryshim.

- Paraqitja dhe përpunimi i metodave dhe mënyrave të ndryshme për një mësim aktiv dhe gjithpërfshirës.
- Realizimi i përgatitjes profesionale të studentëve duke u përqëndruar në çështje të tilla si, strategjitë e të nxënës, punët kërkimore dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës.
- Zhvillimi i aftësive praktike dhe profesionale të studentëve duke përdorur metoda që sigurojnë një përvetësim aktiv.
- Pajisja e studentëve me njohuri bashkëkohore shkencore në fushën e **Biologji–Kimisë**.
- Zhvillimi i aftësive praktike dhe profesionale të studentëve në teknikat e laboratorit dhe eksperimentit në **Biologji dhe Kimi** duke përdorur metoda që sigurojnë një përvetësim aktiv të njohurive të marra në teori, aftësive komunikuese në seminare dhe në praktikën mësimore.
- Një objektivi tjetër është pajisja e studentëve me njohuri metodologjike të Edukimit Shëndetësor. Kjo synon t’ju japë studentëve njohuri mbi konceptet bazë të shëndetit si dhe faktorët përcaktues të tij.
- Një objektivi tjetër është të përdorë teknologjitë e informacionit dhe të komunikimit, si mjete për sigurimin dhe komunikimin e informacionit në **Biologji-Kimi**.
- Në përfundim të këtij kursi studimi studenti merr formimin bazë metodologjik, shkencor dhe praktik në disiplinat që përmban kurrikula e degës së **“Biologji-Kimisë”**.
- Pas marrjes së Diplomës “Bachelor” hidhet hapi i parë drejt profesionit të mësuesit për sistemin parauniversitar si në shkollat publike dhe jopublike, duke iu përgjigjur sa më mirë tregut të punës.
- Diploma “Bachelor” në **Biologji-Kimi** jep mundësi për të vazhduar studimet e Ciklit të Dytë “Master Profesional” dhe “Master Shkencor”.
- Të nxitë e studentët për të kryer punë kërkimore shkencore dhe eksperimentale duke shfrytëzuar burime të ndryshme informacioni (literaturë bashkëkohore, site interneti, periodikë, manuale didaktike etj) si dhe **laboratorët e Biologjisë dhe Kimisë** me infrastrukturë bashkëkohore që disponon Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Humane.
- Diploma “Bachelor” në **Biologji-Kimi** e lëshuar prej Universitetit “Fan.S.Noli” në Korçë, përveç aksesit për të vazhduar studimet e ciklit të dytë të jep mundësinë për të punuar si :

- Mësues në arsimin parauniversitar publik ose jopublik.
- Punonjës për institute të ndryshme, shtetërore ose private që merren me shërbime ose punë kërkimore në **Biologji dhe Kimi**.

6. STRUKTURAT AKADEMIKE PËRGJEGJËSE DHE STRUKTURAT E TJERA BASHKËPUNUESE

Fakulteti apo një strukturë tjetër mësimore e kërkimore	FAKULTETI I SHKENCAVE NATYRORE DHE HUMANE Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë.
Strukturat e tjera bashkëpunuese brenda institucionit apo në institucione të tjera të arsimit të lartë	MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS DREJTORIA ARSIMORE RAJONALE KORÇË FAKULTETI I EDUKIMIT, UNIVERSITETI “FAN S. NOLI” KORÇË. FAKULTETI I BUJQËSISË, UNIVERSITETI “FAN S. NOLI”, KORÇË
Subjekte të tjera publike apo private.	

7. STRUKTURA E PLANIT MËSIMOR PËR VITIN AKADEMIK 2014-2015

Tipi i veprimtarisë dhe simboli përcaktues për të	Fushat disiplinore apo veprimtari të tjera formuese	Kredite	Totali i krediteve
Veprimtari në disiplina të formimit të përgjithshëm (bazë) (Simboli: A)	Matematikë	5	36
	Informatikë	4	
	Fizikë e përgjithshme	5	
	Bio-Kimi	8	
	Kimi Fizike e koloidale	5	
	Kimi Analitike	5	
	Biofizikë	4	
Veprimtari në disiplina karakterizuese programit të studimit (Simboli: B)	Kimi e përgjithshme	11	105
	Biologji qelizore	5	
	Zoologji invertebrore	12	
	Botanikë	6	
	Kimi inorganike	11	
	Kimi organike	11	
	Zoologji vertebrore	6	
	Embriologji-Histologji	5	

	Anatomia e njeriut	4	
	Sistematika e bimëve	7	
	Fiziologji e bimëve	7	
	Fiziologji shtazore	4	
	Fiziologji e njeriut	4	
	Gjenetikë	6	
	Mikrobiologji	6	
Veprimtari në disiplina të ngjashme ose/dhe integruese, që lidhen me disipinat karakterizuese (Simboli: C)	Psikopedagogji	8	8
Disiplina me zgjedhje të studentit, ndër disipinat e ofruara nga institucioni (Simboli: D)	Antropologji	3	11/11
	Edukim shëndetësor	3	
	Edukim mjedisor	4	
	Bioteknologji	4	
	Teknologji kimike	4	
Njohuri të tjera formuese, si plotësime gjuhë të huaja, informatikë, prezantuese, stazh apo praktika, etj. (Simboli: E)	Gjuhë e huaj	5	15
	Praktikë në Zoologji I	2	
	Praktikë në Botanikë I	2	
	Praktikë në terren në Zoologji II	2	
	Praktikë në terren në Botanikë II	2	
	Praktikë e Fiziologjisë së bimeve	2	
Provimi i Diplomës/Teza e diplomës (Simboli: F)	Teza e diplomës	5	5
Totali			180

Gërmat A - F janë përdorur si simbole për veprimtaritë e ndryshme formuese në bazë të Udhëzimit Nr. 15. Datë 04.04.2008, “Për organizimin e studimeve në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë”,

A→ Veprimtari formuese në një ose më shumë grupe disipinash që lidhen me formimin e përgjithshëm (Bazë) për programin e studimit;

B→ Veprimtari formuese në një ose më shumë grupe disipinash që karakterizojnë përkatësinë e programit të studimit;

C→ Veprimtari formuese në një ose më shumë grupe disiplinash të ngjashme ose/dhe integruese me disiplinat karakterizuese që lidhen kryesisht me formime ndërdisiplinore, etj;

D→ Veprimtari formuese të zgjedhura nga studentët, ndërmjet atyre të ofruara nga institucioni dhe koherente me programin e studimit, të realizuara këto gjatë viteve akademike të programit të studimit;

E→ Veprimtari formuese të parashikuara më sipër dhe të fokusuara drejt përfitimit të aftësive në gjuhën e huaj, aftësive informatike dhe telematike, komunikuese dhe prezantuese, ose përgjithësisht të aftësive që lehtësojnë hyrjen në tregun e punës, sikurse edhe aktivitete formuese që lidhen me praktikat profesionale.

F→ veprimtari formuese që lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës.

Në programin e studimit parashikohen:

- leksione **Po**
- ushtrime **Po**
- laboratore **Po**

- projekt/detyra **Po**
- seminare **Po**
- praktikë, stazh, etj, **Po**

8. TË DHËNA PËR PERSONELIN AKADEMIK QË MBULON DISIPLINAT E MËSIPËRME

Për realizimin këtij programi studimi do të angazhohet efektiviteti i Grupit mësimor kërkimor të Biologji–Kimisë pranë departamentit të Infermierisë, pedagogë nga departamente të tjerë të Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Humane, Universiteti “Fan S. Noli” të Korçës, pedagogë nga Fakulteti i Edukimit, Universiteti “Fan S. Noli” i Korçës, pedagogë nga departamenti Biokimi-Agrorshqim Fakulteti Bujqësisë Universiteti “Fan S. Noli” të Korçës. Në tabelën e mëposhtme paraqitet një listë e pedagogëve të parashikuar në procesin e mësimdhënies

Nr	Personeli akademik (me kohë të plotë ose të pjesshme)	Titulli apo grada shkencore	Institucioni i Universitetit "Fan S. Noli"	Dep./Qendra Njësia kryesore	Lëndët/Modulet përkatëse
1	Irena Kallço	Prof.as.dr	Fakulteti i Bujqësisë	Departamenti i Biokimi-Agroushqim	1.Mikrobiologji-Leksione, Seminare
2	Spiro Gjançi	Dr.	Fakulteti i Bujqësisë	Departamenti i Biokimi-Agroushqim	1.Kimi organike-Leksione
3	Lorena Margo	Msc	FSHNH	Departamenti i Matematikës	1.Matematikë
4	Ilir Çapi	Msc	FSHNH	Departamenti i Informatikës dhe Fizikës	1.Informatikë-Leksione
5	Esmeralda Guliqani	Msc	FSHNH	Departamenti i Informatikës dhe Fizikës	1.Fizikë e përgjithshme
6	Sulltana Ajçe	Dr	Fakulteti i Bujqësisë	Departamenti i Biokimi-Agroushqim	1.Kimi e përgjithshme
7	Desareda Mero	Doktorante	FSHNH	Departamenti i Infermierisë Grupi mësimor kërkimor i Biologji-Kimisë	1.Biologji qelizore 2.Anatomi e njeriut 3.Gjenetikë 4.Zoologji vertebrorë
6	Rezana Pengu	Doktorante	Fakulteti i Bujqësisë	Departamenti i Biokimi-Agroushqim	1.Botanikë 2.Sistematika e bimëve
10	Arben Gjata	Dr.	FSHNH	Departamenti i Infermierisë Grupi mësimor kërkimor i Biologji-Kimisë	1.Kimi inorganike 2.Kimi Analitike
11	Viola Prifti	Doktorante	Fakulteti i Bujqësisë	Departamenti i Biokimi-Agroushqim	1.Biokimi 2.Fiziologji shtazore
12	Tanja Kamburi	Doktorante	FSHNH	Departamenti i Infermierisë Grupi mësimor kërkimor i Biologji-Kimisë	1.Edukim mjedisor 2.Kimi organike Laboratore,Seminare 3.Kimi Fizike e koloidale 4.Bioteknologji 5.Teknologji kimike
13	Elda Nuni	Dr.	FSHNH	Departamenti i Infermierisë	1.Embriologji-Histologji

14	Thoma Lice	Dr.	FSHNH	Departamenti i Informatikës dhe Fizikës	1.Biofizike
15	Andi Petro	Msc.	FE	Departamenti i edukimit	1.Psikopedagogji
16	Eralda Belishta	Msc	Me kontratë FSHNH	Departamenti i Infermierisë Grupi mësimor kërkimor i Biologji-Kimisë	1.Edukim shëndetësor 2.Fiziologji e bimeve 3.Ekologji 4.Praktikë e Fiziologjisë së bimëve
17	Xhuliana Qirinxhi	Msc	Me kontratë FSHNH	Departamenti i Infermierisë Grupi mësimor kërkimor i Biologji-Kimisë	1. Zoologji invertebrore-Laboratore, Praktikë në terren 2.Antropologji 3.Mikrobiologji-Laboratore
18	Eda Stasa	Dr	FSHNH	Departamenti i Infermierisë	1. Fiziologji e njeriut
19	Mitjana Trungu		F.E	Departamenti te Gjuhëve të huaja	1.Gjuhe Angleze
20			Me kohë të pjesshme		1. Praktikë në Botanikë I 2. Praktikë në Botanikë II 3. Praktikë në Zoologji

F.SH.N.H - Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Humane

F.B.-Fakulteti i Bujqësisë

F.E. - Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë

U.Korçës – Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë.

a, b, c, d. – Modulet e lëndëve

9. PLANI MËSIMOR I PROGRAMIT TË STUDIMIT BIOLOGJI-KIMI, CIKLI I PARË, VITI AKADEMIK 2013-2014

Viti I (parë)

Nr.	Disiplina apo titulli i veprimtarisë	Tipi i veprim.	Kreditet	Leks.	Sem.	Lab.	Tot.	Simestri	Frekuentimi
1.	Matematikë	A	5	30	30	-	60	I	I detyrueshëm
2.	Informatikë	A	4	30	15	-	45	I	I detyrueshëm
3.	Fizikë e përgjithshme	A	5	30	20	15	65	I	I detyrueshëm
4.	Kimi e përgjithshme	B	11	65	26	39	130	II	I detyrueshëm
5.	Biologji qelizore	B	5	30	20	10	60	I	I detyrueshëm
6.	Zoologji invertebrore	B	12	70	30	45	145	I	I detyrueshëm
7.	Botanikë	B	6	39	13	39	91	II	I detyrueshëm
8.	Antropologji	D	3	26	13	-	39	II	Me zgjedhje
9.	Edukim shëndetësor	D	3	26	13	-	39	II	Me zgjedhje
10.	Gjuhë e huaj	E	5	-	65	-	65	II	I detyrueshëm
11.	Praktikë në Zoologji I	E	2	-	-	-	25	II	I detyrueshëm
12.	Praktikë në Botanikë I	E	2	-	-	-	25	II	I detyrueshëm
	GJITHSEJ		60	320	232	148	750		
	viti i parë								

Viti II (i dytë)

Nr.	Disiplina apo titulli i veprimtarisë	Tipi i veprim.	Kreditet	Leks.	Sem.	Lab.	Tot.	Simestri	Frekuentimi
-----	--------------------------------------	----------------	----------	-------	------	------	------	----------	-------------

1	Biokimi	A	8	52	13	39	104	IV	I detyrueshëm
2	Kimi inorganike	B	11	60	30	45	135	III	I detyrueshëm
3	Kimi organike	B	11	60	30	45	135	III	I detyrueshëm
4.	Zoologji vertebrorë	B	6	39	13	26	78	IV	I detyrueshëm
5.	Embriologji-Histologji	B	5	26	13	26	65	IV	I detyrueshëm
6.	Anatomia e njeriut	B	4	26	13	13	52	IV	I detyrueshëm
7.	Sistematika e bimëve	B	7	45	15	30	90	III	I detyrueshëm
8.	Edukim mjedisor	D	4	26	13	13	52	IV	Me zgjedhje
9.	Bioteknologji	D	4	26	26	-	52	IV	Me zgjedhje
10.	Praktikë në terren në Zoologji II	E	2	-	-	-	25	IV	I detyrueshëm
11.	Praktikë në terren në Botanikë II	E	2	-	-	-	25	IV	I detyrueshëm
GJITHSEJ (viti i dytë)			60	334	153/140	224/237	761		

Viti III (i tretë)

Nr	Disiplina apo titulli i veprimtarisë	Tipi i veprim.	Kreditet	Leks.	Sem.	Lab.	Tot.	Simestri	Frekuentimi
1	Kimi Fizike e koloidale	A	5	42	28	-	70	VI	I detyrueshëm

2	Kimi analitike	A	5	35	-	35	70	VI	I detyrueshëm
3	Biofizikë	A	4	30	15	-	45	V	I detyrueshëm
4.	Fiziologji e bimëve	B	7	45	15	30	90	V	I detyrueshëm
5.	Fiziologji shtazore	B	4	30	15	15	60	V	I detyrueshëm
6.	Fiziologji e njeriut	B	4	30	15	15	60	V	I detyrueshëm
7.	Gjenetikë	B	6	30	30	15	75	V	I detyrueshëm
8.	Mikrobiologji	B	6	28	14	28	70	VI	I detyrueshëm
9.	Psikopedagogji	C	8	56	42	-	98	VI	I detyrueshëm
10	Teknologji kimike	D	4	30	15	-	45	V	Me zgjedhje
11	Ekologji	D	4	30	15	-	45	V	Me zgjedhje
12	Praktikë e Fiziologjisë së bimeve	E	2	-	-	-	25	VI	I detyrueshëm
13	Mikrotezë/ Provim formimi	F	5	-	-	-	-	VI	I detyrueshëm
GJITHSEJ (Viti i tretë)			60	356	189	138	708		

8.1 LËNDET DHE MODULET E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Nr.	Lënda	Tipi i veprimtarisë	Kreditet	Leks.	Sem.	Lab.	Total	Jashtë auditor	Simestri	Departamenti
I	Matematikë	A								
	Moduli 1: Matematikë	A	5	30	30	-	125	65	I	Matematikë
	Moduli 2: Informatikë	A	4	30	15	-	100	55	I	Informatikës dhe Fizikës
	GJITHSEJ		9	60	45	-	225	120		
II	Fizikë e përgjithshme	A	5	30	20	15	125	60	I	Informatikës dhe Fizikës
III	Kimi e përgjithshme	B	11	65	26	39	275	145	II	Biokimi-Agroushqim
IV	Biologji									
	Moduli 1: Biologji qelizore	B	5	30	20	10	125	65	I	Infermierisë, Grupi mesimor kërkimor i Biologji-kimisë
	Moduli 2: Zoologji invertebrorë	B	12	70	30	45	300	155	I	Infermierisë, Grupi mesimor kërkimor i Biologji-kimisë
	Moduli 3: Praktikë në Zoologji	E	2	-	-	25	50	25	II	Infermierisë, Grupi mesimor kërkimor i Biologji-kimisë
	GJITHSEJ		19	100	50	80	475	245		
V	Botanikë	B	6	39	13	39	150	59	II	Biokimi-Agroushqim
	Moduli 1: Praktikë në	E	2	-	-	25	50	25	II	Biokimi-

	Botanikë									Agroushqim
	GJITHSEJ		8	39	13	64	200	84		
VI	Gjuhë e huaj	E	5	-	65	-	125	60	II	Gjuhës Angleze
VII	Lëndë me zgjedhje									
	Moduli 1: Antropologji	E	3	26	13	-	75	36	II	Infermierisë, Grupi mesimor kërkimor i Biologji-kimisë
	Moduli 2: Edukim shëndetësor	E	3	26	13	-	75	36	II	Infermierisë, Grupi mesimor kërkimor i Biologji-kimisë
	GJITHSEJ		3	26	13	-	75	36		
	GJITHSEJ VITI I PARË		60	320	232	198	1500	750		
I	Biokimi	A	8	52	13	39	200	96	IV	Biokimi-Agroushqim
II	Kimi inorganike	B	11	60	30	45	275	140	III	Biokimi-Agroushqim
III	Kimi organike	B	11	60	30	45	275	140	III	Biokimi-Agroushqim
IV	Zoologji vertebrorë	B								
	Moduli 1: Zoologji vertebrorë	B	6	39	13	26	150	72	IV	Infermierisë, Grupi mesimor kërkimor i Biologji-kimisë
	Moduli2: Embriologji-	B	5	26	13	26	125	60	IV	Infermierisë

	Histologji									
	Moduli 3: Praktikë në terren në Zoologji II	E	2	-	-	25	50	25	IV	Infermierisë, Grupi mesimor kërkimor i Biologji-kimisë
	GJITHSEJ		13	65	26	77	325	157		
V	Anatomia e njeriut	B	4	26	13	13	100	48	IV	Infermierisë, Grupi mesimor kërkimor i Biologji-kimisë
VI	Sistematika e bimëve	B								
	Moduli 1: Sistematika e bimëve	B	7	45	15	30	175	85	III	Biokimi-Agroushqim
	Moduli 2: Praktikë në terren në Botanikë II	E	2	-	-	25	50	25	IV	Biokimi-Agroushqim
	GJITHSEJ		9	45	15	55	225	110		
VII	Lëndë me zgjedhje									
	Moduli 1: Edukimi mjedisor	D	4	26	13	13	100	48	IV	Infermierisë, Grupi mesimor kërkimor i Biologji-kimisë
	Moduli 2: Bioteknologji	D	4	26	26	-	100	48	IV	Infermierisë, Grupi mesimor kërkimor i Biologji-kimisë
	GJITHSEJ		4	26	13/26	13	100	48		
	GJITHSEJ VITI I DYTË		60	334	140/153	287/274	1500	739		
I	Kimi									
	Moduli 1: Kimi Fizike e koloidale	A	5	42	28	-	125	55	VI	Infermierisë, Grupi

										mesimor kërkimor i Biologji-kimisë
	Moduli 2:Kimi Analitike	A	5	35	-	35	125	55	VI	Biokimi-Agroushqim
	GJITHSEJ		10	77	28	35	250	110		
II	Biofizikë	A	4	30	15	-	100	55	V	Informatikës dhe Fizikës
III	Fiziologjia									
	Moduli 1:Fiziologji e bimëve	B	7	45	15	30	175	85	V	Infermierisë, Grupi mesimor kërkimor i Biologji-kimisë
	Moduli 2:Fiziologji shtazore	B	4	30	15	15	100	40	V	Biokimi-Agroushqim
	Moduli 3:Fiziologji e njeriut	B	4	30	15	15	100	40	V	Biokimi-Agroushqim
	Praktikë e Fiziologjisë së bimeve	E	2	-	-	25	50	25	VI	
	GJITHSEJ		17	105	45	85	425	190		
IV	Gjenetikë	B	6	30	30	15	150	75	V	Infermierisë, Grupi mesimor kërkimor i Biologji-kimisë
V	Mikrobiologji	B	6	28	14	28	150	80	VI	Biokimi-Agroushqim
VI	Psikopedagogji	C	8	56	42	-	200	102	VI	Shkencave sociale
VII	Lëndë me zgjedhje	D								
	Moduli 1:Teknologji kimike	D	4	30	15	-	100	55	V	Infermierisë, Grupi mesimor kërkimor i Biologji-kimisë

	Moduli 2:Ekologji	D	4	30	15	-	100	55	V	Infermierisë, Grupi mesimor kërkimor i Biologji-kimisë
	GJITHSEJ		4	30	15	-	100	55		
	Mikroteze /Provim formimi		5	-	-	-	125	125	V	
	GJITHSEJ VITI I TRETE		60	356	189	163	1500	792		

UNIVERSITETI FAN S. N

9-14 DETYRIMET E MUNDSHME QË LIDHEN ME FREKUENTIMIN

1. Hartimi i kësaj Rregulloreje është bazuar në ligjin “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në udhëzimin nr. 15, dt. 15.4.2008 “Për organizimin e studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë” në Rregulloren e studimeve të Universitetit “FAN S. NOLI” Korçë etj.

Kjo Rregullore mësimore është bërë në përputhje me planin mësimor, duke respektuar liritë akademike, si dhe të drejtat e detyrat e personelit akademik dhe të studentëve.

Departamenti “Infermierisë dhe Grupit mësimor kërkimor i Biologji–Kimisë” ofron për studentët një program studimi **programi i studimit të ciklit të parë BIOLOGJI-KIMI**, me kohë të plotë. Rregullorja specifikon aspektet organizative të programeve të studimit të ciklit të parë në Fakultetin e Shkencave të Natyrës dhe Humane të Universitetit “Fan S.Noli”.

PRANIMI NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE

1.Çdo person që ka përfunduar me sukses Maturën Shtetërore, ka të drejtë të kandidojë për t’u pranuar në ciklin e parë të studimeve të UK.

2.Ciklin e parë të studimeve në UK mund ta ndjekin edhe studentë të huaj, bazuar në marrëveshjet dypalëshe ose shumëpalëshe.

3.Ciklin e parë të studimeve mund ta ndjekin edhe shtetas shqiptarë e të huaj që kanë përfunduar studimet e larta (program studimi i dytë), kundrejt pagimit të tarifës së caktuar.

KUSHTET PËR PROCEDURAT DHE MODALITETET PËR TRANSFERIMIN E STUDENTËVE

- Studentët mund të transferohen nga një universitet në tjetrin brenda të njëjtit program studimi vetëm pas përfundimit të vitit të parë.
- Komisioni vlerësues, që ngrihet në fakultet, vlerëson rast pas rasti dokumentacionin dhe formimin e studentit, për të përcaktuar nëse i duhet të shlyejë ndonjë lëndë, që ai nuk e ka zhvilluar në vitin e parë.
- Kërkesat për transferim duhet të dorëzohen brenda datës 10 të muajit shtator në sekretarinë mësimore. Vlerësimi i dokumentacionit bëhet brenda datës 15 shtator dhe njoftimi një ditë më pas.

FREKUENTIMI NË VEPRIMTARITË E NDRYSHME FORMUESE

Frekuentimi është i detyrueshëm. Detyrimet për frekuentimin e veprimtarive mësimore përcaktohen në:

- Leksione **70%**
- Seminare dhe ushtrime **80%**
- Laboratore **100%**

Në përfundim të studimeve të ciklit të parë studenti duhet të arrijë të fitojë 180 kredite.

. FORMAT E STUDIMIT DHE TË VLERËSIMIT

- Format e studimit dhe të vlerësimit është trajtuar hollësisht në Rregulloren e studimeve të Universitetit “Fan S.Noli”.
- Forma e studimit është me **kohë të plotë**.
- Procesi i vlerësimit të studentëve është pjesë e rëndësishme e procesit mësimor që kryhet përgjatë zhvillimit të një disipline dhe finalizohet me zhvillimin e provimeve e shpalljen e përfundimeve.

a. Vlerësimi i studentit

- Vlerësimi i studentit ndahet në dy pjesë: **vlerësimi i vazhdueshëm** gjatë vitit për elementet e përcaktuar në programin e disipinës a modulit dhe **vlerësimi përfundimtar**.
- Vlerësimi i vazhdueshëm gjatë vitit përfaqëson 30% të vlerësimit total. Përbërësit e vlerësimit të vazhduar bëhen nga çdo pedagog në programin e disipinës a modulit dhe pasqyrohen në rregulloren e programit të studimit.
- Në përfundim të procesit mësimor (në orët e fundit të mësimimit), çdo pedagog që është përgjegjës lënde duhet t’u komunikojë studentëve në auditor:
 1. fitimin ose jo të së drejtës për t’u futur në provimin e disipinës (modulit) përkatëse;
 2. rezultatin e vlerësimit të vazhdueshëm në seminare, laboratore, tema e detyra kursi apo në forma të tjera kontrolli të ushtruara gjatë semestrit, si pjesë e vlerësimit përfundimtar.
 3. rezultati i vlerësimit të vazhdueshëm merret parasysht vetëm në vlerësimin përfundimtar të studentit, në sezonin e parë të provimeve.
- Mënyrat e kontrollit të dijes (provim) përcaktohen në programin e disipinës a modulit

b. Llojet e provimeve

- Provimi është formë e kontrollit të dijeve që duhet të përfundojë brenda afateve të parashikuara.
- Kontrolli i dijeve mund të bëhet: a) me shkrim, b) me gojë, c) i kombinuar (me shkrim e me gojë). Departamenti përcakton nëse pjesa me shkrim e provimit mund të jetë përcaktuese apo eliminuese.

- Tezat e provimit hartohen nga titullari i disiplinës dhe miratohen nga përgjegjësi i departamentit.
- Gjatë zhvillimit të provimit (me shkrim ose me gojë) nuk lejohet ndërrimi i tezës.
- Zgjedhja e formës së provimit bëhet nga pedagogu/ët i lëndës dhe pasqyrohen në rregulloren mësimore të programit të studimit qysh në fillim të semestrit, duke ua bërë të ditur studentëve

c. Dokumentacioni i provimit

- Një kopje e tezave të provimit me gojë për çdo disiplinë ruhen në departament. Ato rinovohen herë pas herë, në varësi të ndryshimit të programit të disiplinës (modulit).
- Procesverbalet e provimit me gojë dorëzohen në sekretari brenda 2 ditëve nga data e zhvillimit të provimit.
- Procesverbalet e provimit me shkrim dorëzohen në sekretari brenda 6 ditëve nga data e zhvillimit të provimit

d. Afatet e përcaktuara për provimet

- Provimet dhe riprovimet në të gjitha format e studimeve zhvillohen sipas afateve të caktuara në strukturën e vitit akademik, të miratuara nga Këshilli i Fakultetit dhe të pasqyruara në grafikun e provimeve.
- Provimet dhe riprovimet zhvillohen në 4 sezone: sezoni i Dimrit (Shkurt, Mars); sezoni i Verës (Qershor, Korrik); sezoni i vjeshtës (Shtator) dhe sezoni plotësues. Në sezonin plotësues për çdo disiplinë apo modul do të ketë vetëm një datë provimi. Ato miratohen dhe shpallen nga Dekani jo më vonë se dy javë para fillimit të sezonit.
- Afatet e përcaktuara për provimet dhe riprovimet janë të detyrueshme për zbatim si nga pedagogët, ashtu dhe nga studentët. Ndryshimi i datës së provimit bëhet vetëm me miratim të dekanit.
- Studenti nuk lejohet të hyjë për të dytën herë në provimin e një discipline, brenda të njëjtit sezon.
- Studenti paraqitet në provim me librezën e studentit. Në mungesë të saj mund të paraqitet edhe dokument tjetër identifikimi.

e. Kohëzgjatja e provimeve

- Kohëzgjatja e një provimi me gojë është jo më shumë se 30 minuta për çdo student, ndërsa provimi me shkrim zgjat jo më pak se 2 orë.
- Pas dhënies së tezës në provimin me shkrim, nuk lejohet futja në provim e studentëve të tjerë të grupit apo kursit përkatës.

- Anëtarët e komisionit të provimit të disiplinës mbikqyrin zhvillimin korrekt të provimit gjatë gjithë kohës, nga dhënia e tezës deri në përfundimin e provimit.

f. Ankimimi për provimin

- Studenti ka të drejtë të ankohet në rast se ndaj tij janë shkelur rregullat procedurale gjatë zhvillimit të provimit ose për vlerësim të pamërituar. Ankesa bëhet me shkrim *brenda ditës së marrjes së rezultatit për provimin me gojë dhe jo më vonë se 8 ditë për provimin me shkrim, nga data e dhënies së tij* dhe i drejtohet dekanit të fakultetit. Ai përcakton nëse ankesa e studentit është e drejtë apo jo dhe merr vendimin përkatës brenda dy ditëve. Ky vendim është i formës së prerë.
- Në rast se vërtetohen praktika që bien ndesh me dispozitat e kësaj rregulloreje, atëhere, me propozimin e Përgjegjësit të Departamentit, dekani vendos për ndryshimin e komisionit të provimit dhe për rihënien e provimit brenda ditës ose të nesërmen, pas përfundimit të tij.

g. Sistemi i vlerësimit

- Studenti që për çfarëdo arsye nuk paraqitet në provimin e një discipline, humbet të drejtën e provimit dhe konsiderohet mbetës për atë disiplinë në atë sezon.
- Gjithashtu studentit vlerësohet mbetës, kur:
 - a. Nuk është i përgatitur;
 - b. Tërhiqet nga provimi;
 - c. Kopjon ose mashtron me mjete ndihmëse jo të lejueshme (në këtë rast ai përjashtohet nga provimi).
 - d. Pengon zhvillimin e rregullt të provimit/kolokiumit (në këtë rast ai përjashtohet nga provimi).
 - e. Studenti nuk lejohet të mbrojë diplomën, nëqoftëse nuk ka shlyer të gjitha detyrimet e vitit të fundit si dhe ato të mbartura.
- Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistemin prej dhjetë notash. Nota kaluese më e ulët është nota pesë.
- Në format e kontrollit me shkrim përdoret edhe sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit, detyrimisht kthehet në notë. Vlerësimi i vazhduar zë 30% të vlerësimit përfundimtar të studentit. Vlerësimi përfundimtar në bazë të totalit të pikëve të provimit dhe vlerësimit të vazhduar do jetë:

deri në 39 pikë	Nota 4
40-50	Nota 5 (minimumi i pikeve 40)
51-60	Nota 6
61-70	Nota 7

71-80	Nota 8
81-90	Nota 9
Mbi 91	Nota 10 (maksimumi i pikeve 100)

- Për vlerësimin përrundimtar të studentit mblidhen pikët e vlerësimit të vazhduar me vlerësimin në provim.
- Çdo student ka llogarinë e tij elektronike ku njihet me rezultatet e provimeve.

RIPROVIMET DHE MBARTJA E PROVIMEVE

Studenti, i vlerësuar mbetës në dy sezonet e rregullta të provimeve (të dimrit dhe të verës), ka të drejtë:

1. Të përdorë të gjitha datat e shpallura nga fakultetet në sezonin e vjeshtës.
2. Për të kaluar në vitin e dytë (semestri i tretë), studentin që ndjek studimet në sistemin me kohë të plotë duhet të ketë përfituar minimumi 20 kredite .
3. Për të kaluar në semestrin e pestë, studentin që ndjek studimet në sistemin me kohë të plotë duhet të ketë përfituar minimumi 60 kredite.
4. Ridhënia e provimeve për disiplinat(modulet) e pashlyera, lejohet gjatë vitit në vazhdim në sezonet e shpallura të provimeve (tri herë në vit) ose deri në vitin e fundit të studimeve.
5. Studenti i vitit të fundit, i cili në përfundim të provimeve të kursit, në sezonin e parë, rezultojn me detyrime mësimore të pashlyera, ka të drejtë t'i shlyejë ato në sezonin e verës, para mbrojtjes së diplomës.
6. Studenti i vitit të fundit, i cili, në përfundim të provimeve të vitit të tretë, rezultojn me detyrime mësimore, i shlyen ato në sezonin e vjeshtës dhe diplomën e mbron në këtë sezon.

DIPLOMIMI

1. Në përfundim të kursit të plotë të studimeve, studentin ka të drejtë të diplomohet për të fituar titullin përkatës profesional. Diplomimi bëhet me mbrojtjen e një teze diplome ose me provim formimi.
2. Departamenti përcakton listën e tezave për diploma në fillim të semestrit të pestë. Ky përcaktim bëhet duke u mbështetur në fushat e studimit që mbulon departamenti.
3. Drejtuesit e tezave të diplomës miratohen nga përgjegjësi i departamentit.
4. Studentin merr përsipër shpenzimet për realizimin e temës së diplomës.
5. Diplomimi bëhet në sezonin e verës (korrik) dhe në sezonin e vjeshtës (shtator).
6. Studentin i lejohet të mbrojë tezën e diplomës vetëm mbasi të ketë shlyer provimet e prapambetura.

7. Kriteret për të mbrojtur tezën e diplomës është kur studentit ka një mesatare mbi 8 për dy vitet e para të studimit.
8. Kriteret e hartimit të pyetjeve për provimin e formimit; Nga disiplinat kryesore hartohen pyetjet që u jepen studentëve 2 muaj para sezonit të provimit.

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË STUDENTËVE DHE TË HARTIMIT TË PUNIMIT PËR MBROJTJEN E DIPLOMËS:

Teza e diplomës të nivelit të parë është një punim, në formën e një projekti apo përmbledhjeje punimesh të kryera në fushat e programit përkatës të studimit. Teza e diplomës përmban kërkesa, mënyra e shtrimit të të cilave i jep mundësi studentit, që nëpërmjet njohurive të fituara gjatë periudhës së shkollimit, të tregojë aftësitë e tij për të zgjidhur elementë të veçantë të detyrave, në fushën përkatëse. Teza e diplomës është e lidhur me disiplina të përafërta dhe duhet të jetë individuale. Studenti që plotëson kriteret e përcaktuara nga kjo rregullore ka të drejtë të shprehë dëshirën e tij në lidhje me tezën e diplomës që kërkon të zhvillojë, dhe udhëheqësin e tij. Departamenti shqyrton të gjitha kërkesat specifike të studentëve, duke i harmonizuar ato me kushtet aktuale.

Struktura e punimit

Punimi duhet të shkruhet me shkrim Times New Roman, Font 12, Hapësira midis rreshtave 1,15.

1. Hyrje: Përse kjo temë? (2 faqe)
2. Çështjet themelore në fushën e brendisë (3 faqe)
4. Argumentet dhe analiza e të dhënave (20 faqe)
5. Përfundime, propozime, bibliografi (5 faqe)

INFRASTRUKTURA NË DISPOZICION TË PROGRAMIT

- *Auditorë.* Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Humane ka në dispozicion 1 auditor me kapacitet rreth 140 vende, 2 auditorë me kapacitet 80 vende 10 klasa për zhvillimin e orëve të seminareve me kapacitet 20-40 vende, Internet 24 orë në gjitha ambientet e fakultetit. Universiteti i "Fan S. Noli" i Korçës ka marrë në pronësi edhe një godinë me 10 klasa me kapacitet 30 vende të cilat janë vënë në dispozicion të programeve master.

- *Laboratorë.* Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Humane ka 2 laboratorë me infrastrukture bashkëkohore pajisje moderne reagente të bollshëm gjë që bën të mundur realizimin e programit mësimor si dhe programin studimor për të kryer punë kërkimore shkencore dhe eksperimentale të studenteve për tezat e diplomave.

1. Laboratori i biologjisë me rreth 30 vende. I pajisur me pajisje bashkëkohore si: mikroskop me fluoreshencë, mikroskopë optikë, centrifugë, inkubator, banjo mari, autoklavë,

peshore elektronike, përzierës elektromagnetik, mikrotom etj. Gjithashtu është i paisur me makete, atlase, reagentë, mjete për realizimin e planit mësimor dhe punës kërkimore.

2. Laboratori i kimisë me rreth 30 vende. I pajisur me pajisje bashkëkohor si: polarimetër, pH metër, centrifuge, banjo mari, distilator, peshore analitike, elektornike, teknike, fotoelektrokolorimetër (FEK), spektrofotometër, flamfotometër, autoklavë, termostat, furrë Mufle, gas analizator, kapë, byreta dixhitale, viskozimetër etj. Gjithashtu është i paisur me reagentë të bollshëm, qelqurina, për realizimin 100% të programit mësimor si dhe për të kryer punë kërkimore për tezat e diplomave.

3. Dy laboratorë informatike me 30 kompjutera secili.

- Në dispozicion të programeve të studimit Departamenti Biokimi-Agroushqim i F.B. të Universitetit “Fan S. Noli” të Korçës ka 2 laboratorë me infrastrukturë bashkëkohore pajisje moderne.

1. Laboratori i mikrobiologjisë me rreth 30 vende. Ka nje eksperience 44 vjecare. I rinovuar me pajisje bashkekohore elektronike, reagente të bollshëm, qelqurina për realizimin 100% të programit mësimor si dhe për të kryer punë kërkimore për tezat e diplomave.

2. Laboratori i metodave të analizave instrumentale me rreth 30 vende. I pajisur me paisje moderne si polarimetra, fotometrat me filtra (FEK), Spektrofotometrat (SF UV-VIS), fotometra me flakë, pH-metra, gaz kromatograf, kromatograf i lëngët me performancë të lartë (HPLC), elektroforezë, të gjitha paisjet ndihmëse për zhvillimin e punëve, reagente të bollshëm, qelqurina për realizimin 100% të programit mësimor si dhe për të kryer punë kërkimore për tezat e diplomave.

- **Biblioteka Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Humane** ka 1 bibliotekë në dispozicion të të gjithë studentëve të fakultetit, e organizuar sipas një sistemi bashkëkohor kërkimi dhe studimi. Kjo bibliotekë garanton mbështetjen e programit të studimit me një informacion të përditësuar të nivelit të lartë.

- **Sekretaria Mësimore Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Humane** Disponon infrastrukturë bashkekohore pune.

- **Departamenti: ‘Infermierisë dhe Grupit mësimor kërkimor i Biologji–Kimisë’** Disponon infrastrukturë bashkekohore pune.